

KËRKESË PËR OFERTË PËR OFRUES TË TRAJNIMEVE PROFESIONALE

Procedura për kuotimin e çmimeve

Numri kërkesës për ofertim:	ICK-CLF-2020/002
Data e publikimit	09.01.2020
Data e mbylljes:	20.01.2020
Titulli i kontratës:	Trajnim Profesional në WordPress
Autoriteti Kontraktues	Innovation Centre Kosovo, ICK
Adresa:	Rr. Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë, RKS
E-mail:	info@ickosovo.com

PËRMBLEDHJE

Innovation Centre Kosovo (ICK) fton subjektet/individët e interesuar/a të paraqesin ofertat për:

- **Trajnim Profesional në WordPress**

Qëllimi i kësaj ftese për ofertim është të identifikojë ofruesit e kualifikuar për trajnimin e kërkuar. Ofertuesit e interesuar duhet të kenë kapacitet për të zhvilluar dhe ofruar trajnime në klasë duke përfshirë materialet, prezantimet, ushtrimet praktike, studimet e rasteve dhe diskutimet në grup. Kompanitë/Ligjëruesit Profesional duhet të ofertojnë sipas kërkesës të paraqitur në këtë dokument.

KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha Kompanitë/Ligjëruesit Profesional të interesuar/a duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim,
- Duhet të shënohet data e ofertës,
- Programin, metodologjinë, kurrikulën e detajuar të trajnimit / trajnimeve si dhe numrin e orëve (një orë e trajnimit = 60 minuta),
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 60 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së (të gjitha në kopje) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve ,
- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve,
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket çmimi për orë 60 minuta (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, ICK-ja do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH-në,
- Duhet të ofrohen referencat mbi shërbime të ngjashme në 3 (tri) vitet e fundit (maximum 3 referenca) si dhe CV-të e Ligjëruesit/ve Profesional që do të mbajë trajnimin,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze,
- Oferta duhet të dorëzohet në zarf të mbyllur në Zyret e ICK-së, Rruga Rexhep Mala 28A, 10000 Prishtinë. Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 20.01.2020, ora 12:00.

***SHËNIM ME RËNDËSI:**

i) Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.

ii) Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.

iii) Çdo palë e interesuar mund të bejë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Oferta duhet të dorëzohet në Zyret e ICK-së.
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 20 Janar 2020, ora 12:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresë: info@ickosovo.com. Pyetjet pranohen deri më 16 Janar 2020.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 20 Janar 2020 ora 13:30 nga Komisioni përzgjedhës (i përbërë nga 3 anëtarë) dhe të gjitha palët e interesuara kanë të drejtë të jenë prezent.
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
1. Kriteret Kualitative	
1.1. Programi, metodologjia dhe kurrikula propozuar	40%
1.2. Përgaditja, historiku dhe përvoja e Ligjëruesit/ve të propozuar	10%
1.3. Referenca me detaje të kontaktit (minimum 3 referenca)	10%
2. Kriteret Financiare	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	40%
Total:	100%